



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC**

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më 20.02.2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Data: 20.02.2024

Drejtuar: Operatorit ekonomik “ALBAVIA” shpk, me NIPT J81527001Q, me adresë: Tirane Tirane TIRANE Rruga Sulejman Delvina, Pallati Fati, shk.1, ap.19.

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e Hapur” - “Pune Publike” - “Elektronike”,

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-46203-10-17-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Loti IV, Ura e Zëmçës – Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë”,

Fondi limit: 220 320 000 (Dyqind e njëzet million e treqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 muaj nga marrja në dorëzim e sheshit të ndërtimit.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë, me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “2 T” shpk, me Nipt K01731001M

Vlera: 187 369 889, 4 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë milion e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë presje katër) Lekë pa TVSH

2. Operatori ekonomik “ALBAVIA” shpk, me Nipt J81527001Q

Vlera: 153 876 474, 78 (njëqind e pesëdhjetë e tre milion e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër presje shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

3. *Operatori ekonomik* “ALKO-IMPEX General Construcion” shpk, me Nipt K91326028I

Vlera: 192 578 543 , 88 (njëqind e nëntëdhjetë e dy milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e dyzet e tre presje tetëdhjetë e tetë) Lekë pa TVSH.

4. *Operatori ekonomik* “PE – VLA - KU” shpk, me Nipt K61716013M,

Vlera: 171 719 233, 8 (njëqind e shtatëdhjetë e një milion e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e tre presje tetë) lekë pa TVSH.

5. *Operatori ekonomik* “SALILLARI” shpk, me Nipt J62903125G,

Vlera: 195 845 297 , 82 (njëqind e nëntëdhjetë e pesë milion e tetëqind e dyzet e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë presje tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1- Operatori ekonomik “2 T” shpk, me Nipt K01731001M, është paraqitur oferta e me vlerë ekonomike 187 369 889, 4 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë milion e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë presje katër) Lekë pa TVSH, por nuk ka arritur të paraqitet i gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DT, konkretisht:

Operatori ekonomik nuk përmbush Kriteret e Vecanta të kualifikimit, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në përmbushje të kësaj pike, rezultojnë mangësi, si më poshtë:

1. Shoqëria nuk disponon mjet (Skrep) të kërkuar në DST.Mjeti i paraqitur referuar fatures së zhdoganimit është fadrome dhe jo SKREP, në DST është specifikuar si mjet skrep që shërben për germim dhe transportin, ndërsa mjeti i paraqitur kryen vetëm transportin e jo ngarkim.

2. Nuk plotëson kriterin 2.3.5. Në përmbushje të kriterit të parashikuar në DST , dy punonjëset e paraqitur Elvis Hidri dhe Ismet Balla , disponojnë certifikata të leshuara nga shoqëria “AQSER” të cilët kanë ndjekur kurse për sigurinë dhe shëndetin në punë , por nuk disponojnë një certifikatë nepermjet të cilit të jenë akredituar si përgjegjës për shëndetin dhe sigurinë në punë

3. Nuk ploteson kriterin 2.3.11 (persa i perket tubo te brinjezuar dhe tombino betoni) pasi nuk eshte deklaruar asnje e dhene e shoqerise ARIEL dhe nuk specifikuar nese eshte distributor ose prodhues. Ne DST eshte specifikuar se: Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit, si telefon, faks, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

4. Nuk ploteson kriterin 2.3.11 persa i perket cimentos pasi ne autorizim kontrate, nuk specifikohet nese leshuesi i saj eshte furnizues apo prodhues i saj. Ne DST eshte specifikuar se: Per rastet kur autorizimi do te jete leshuar nga distributor i autorizuar , duhet te shoqerohet dhe me dokumentacionon qe verteton lidhjet e firmes prodhuese me distributorin. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota ate prodhuesit si telefon faks , e-mail ,ëebsite , kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimin nga ana e tij.

5. Ne permbushje te kriterit nr.2.3.9 te DST OE ka paraqitur mjetin me targe AA183FB kamioncine per te cilin polica e sigurimit ka skaduar ne date 08.11.2022.

6. Ne permbushje te kriterit nr.2.3.9 te DST jane kerkuar 6 Autoveteshkarkues mbi 8 ton nga ku rezulton se:

6.1-OE ka paraqitur mjetin me targe AA706PK per te cilin rezulton se certifikata e kontrollit teknik ka skaduar ne date 15.12.2022 dhe polica e sigurimit ne daten 10.12.2022.

6.2.OE ka paraqitur mjetin me targe AA944RH per te cilin rezulton se certifikata e kontrollit teknik ka skaduar ne date 04.11.2022.

6.3.OE ka paraqitur mjetin me targe AA431SJ per te cilin rezulton se certifikata e kontrollit teknik ka skaduar ne date 09.12.2022.

6.4.OE ka paraqitur mjetin me targe AA709PK per te cilin rezulton se certifikata e kontrollit teknik dhe polica e sigurimit kane skaduar ne date 09.12.2022.

6.5.OE ka paraqitur mjetin me targe AA455SJ per te cilin rezulton se certifikata e kontrollit teknik ka skaduar ne date 09.12.2022.

6.6.OE ka paraqitur mjetin me targe AA714SS per te cilin rezulton se certifikata e kontrollit teknik ka skaduar ne date 20.12.2022.

6.7.OE ka paraqitur mjetin me targe AA836UZ per te cilin rezulton se certifikata e kontrollit teknik ka skaduar ne date 15.12.2022.

6.8. OE ka paraqitur mjetin me targe AA093XJ per te cilin rezulton se certifikata e kontrollit teknik ka skaduar ne date 13.12.2022.

7. OE ka paraqitur autobitrumatrice me targe AB549CJ per te cilin certifikata e kontrollit teknik ka skaduar ne date 16.12.2022 dhe polica e sigurimit ka skaduar ne 15.12.2022.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të pikës 2 të nenit 82 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 92 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e OE “**2T**” **shpk nuk** është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme.**

- 2- *Nga Operatori ekonomik “ALKO-IMPEX General Construcion” shpk, me Nipt K91326028I, është paraqitur oferta ekonomike me vlerë ekonomike: 192 578 543 , 88 (njëqind e nëntëdhjetë e dy milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e dyzet e tre presje tetëdhjetë e tetë) Lekë pa TVSH, por nuk ka arritur te paraqitet I gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DT, konkretisht:*

1. Nga shoqëria mbështetese “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” shpk, nuk janë paraqitur listepagesat e kerkuara per periudhen korrik-shtator 2022, per te verifikuar punonjesit e paraqitur nga kjo shoqëri (teknike ndertimi + manovratore), te cilet do te mbështesin OE ofertues “Alko-ImpeX General Construcion” shpk.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e “**ALKO-IMPEX General Construcion**” shpk, me Nipt K91326028I, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme.**

- 3- *Nga Operatori ekonomik “Operatori ekonomik “PE – VLA - KU” shpk, me Nipt K61716013M, është paraqitur oferta ekonomike me vlerë: 171 719 233, 8 (njëqind e shtatëdhjetë e një milion e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e tre presje tetë) lekë pa TVSH, por nuk ka arritur te paraqitet I gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DT, konkretisht:*

1- Në pikën 2.3.9 “Makinë dhe Pajisje”, Mjeti AUTOBITUMATRICE 1 copë, rezulton se Certifikata e Kolaudimit të mjetit ka përfunduar vetem 1 dite përpara zhvillimit të procedurës, pra në datë 01.11.2022, ndërkohë që procedura është zhvilluar në datë 02.11.2022.

2- Në pikën 2.3.9 “Makinë dhe Pajisje”, Mjeti Kamioncine me targë AB036BU, 1 copë, rezulton se Polica e Sigurimit të mjetit ka përfunduar ne date 12.12.2022.

3- Në pikën 2.3.9 “Makinë dhe Pajisje”, Mjeti Kamioncine me targë AB036BU, 1 copë, rezulton se Taksa Vjetore e mjetit ka përfunduar përpara dorëzimit të dokumentacionit.

4. Në pikën 2.3.11 “*Autorizim Prodhuesi / Kontratë Bashkëpunimi*”, OE ka paraqitur autorizim prodhuesi për materialin (Hekur-Cimento) nga “Rafaelo 2002” sha., i cili mban datën 26.12.2022, datë kjo në të cilën procedura e prokurimit ende nuk ishte zhvilluar.
5. OE rezulton që të ketë ndryshuar analizën teknike dhe cmimin për zërin Punime Elektrike – Analiza 3. FV ndricues MINITONALE-SAP-T 250 W, i zëvendësuar me Ndricules LED Philips 116W 17600 Lumen, me arsyen që produkti i kërkuar nuk gjendet në treg, pa kërkuar me pare miratimin e Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec per kete ndryshim.
6. Mjeti me targe AA730HA i ka perfunduar polica e sigurimit ne date 13.12.2022.
7. Në pikën 2.3.7 “*Stafi Teknik*”, 6 Manovratore te kerkuar rezulton si me poshte:

-Manovratori Florjan Doni, Deshmia e Aftesimit Profesional e palexueshme

- Manovratori Qemal Rusi, Deshmia e Aftesimit Profesional ka skaduar me date 27.06.2022.

- Ne te dyja Vetedeklarimet (PE-VLA-KU dhe PE-VLA-KU KOSOVE) rezultojne te deklaruar te njejtet emra punonjesish, si me poshte:

- Enver Cufaj – *Teknik Ndertimi*
- Adela Lami - *Teknik Ndertimi*
- Kristo Papas – *Elektracist + Shofer*
- Bledar Doni – *Manovrator*
- Ermal Shkambaj – *Manovrator*
- Alket Doni – *Manovrator*
- Florjan Doni – *Manovrator*
- Qemal Rusi – *Manovrator*
- Redi Berberi - *Manovrator*
- Elias Toromani – *Shofer*
- Rogert Mici – *Shofer*
- Lavdi Baruni – *Shofer*

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e “**PE – VLA - KU**” **shpk**, me Nipt K61716013M, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme.**

- 4- Nga Operatori ekonomik: "SALILLARI" shpk, me Nipt J62903125G, me oferte ekonomike 195 845 297 , 82 (njëqind e nëntëdhjetë e pesë milion e tetëqind e dyzet e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë presje tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, por nuk ka arritur te paraqitet i gjithe dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DT, konkretisht:

1. Ne Piken 2.3.9 Te DST:

-Shoqeria nuk disponon mjet (Skreper) te kerkuar ne DST.

Mjeti i paraqitur referuar formularit te deklarimit ka keto te dhena: Skreper 6 m3 , Nr. Lejes se qarkullimit 03 , Nr. shasisë 0667 , te tjera Cat 980G. Ndersa dokumentacioni i paraqitur per kete mjet eshte nje fature tatimore per mjetin fadrome dhe jo SKREPER. Ne DST eshte specifikuar si mjet skreper qe sherben per germim dhe transportin, ndersa mjet i paraqitur kryen vetem transportin e jo ngarkim. Per me teper fadroma e paraqitur eshte e pa pajisur me Leje qarkullimi, Certifikaten e kontrollit teknik si dhe police sigurimi, dokumentacion ky i nevojshem sipas Kodit Rrugor dhe Ligjit "Per sigurimin e detyrueshem ne transportin publik".

2. Shoqeria ka paraqitur dy mjete Grejder, perkatesisht me fatura zhdoganimi dhe me foto, por nuk ka paraqitur dokumentacionin tjeter te nevojshem per keto mjete, sic parashikon Kodi Rrugor dhe Ligji "Per sigurimin e detyrueshem ne trasportin publik", konkretisht (Leje qarkullimi, Certifikaten e kontrollit teknik si dhe police sigurimi).

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e "SALILLARI" shpk, me Nipt J62903125G, me Nipt L78006801F, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: Operatorin ekonomik "ALBAVIA" shpk, me NIPT J81527001Q, me adresë, Tirane Tirane TIRANE Rruga Sulejman Delvina, Pallati Fati, shk.1, ap.19., se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **153 876 474, 78 (njëqind e pesëdhjetë e tre milion e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër presje shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë: **Bashkisë Pogradec**, me adresë: Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja Nr. 2, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes / publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar, tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do të procedohet, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO JO

Pas Publikimit te Njoftimit te Anulimit, brenda afatit te Ankimit, jane paraqitur Ankesa nga Operatoret Ekonomike “ALBAVIA” shpk, e cila mban numrin Prot 561/2023, date 15.03.2023, dhe “ALKO-IMPEX General Construcion” me nr. Aplikimi A/2023/2963, date 16.03.2023, te trajtuara nga Komisioni i Prokurimit Publik, i cili ka dale me Vendimin Perfundimtar nr. 337/2023, date 03.05.2023.

Me pas, ky Vendim, eshte kundershuar nga ana e Operatorit Ekonomik “ALBAVIA” shpk ne Gjykaten Administrative te Apelit, nepermjet kerkese padise NR. 154 Akti, date 22.05.2023, protokolluar prane Bashkise Pogradec, si pale e trete, me nr. 2117/1 prot, date 26.05.2023.

Me Vendimin e Formes se Prere Nr. 79 (86-2023-1022), date 10.10.2023, protokolluar prane Bashkise Pogradec me nr. 707 prot, date 12.02.2024, Gjykata Administrative e Apelit Tirane, ka vendosur “*Pranimin e padise se paditesit “ALBAVIA” shpk dhe Shfuqizimin e pikes 6 te Vendimit nr. 337/2023 te Komisionit te Prokurimit Publik...*”, nepermjet te ciles, legjitimohet Autoriteti Kontraktor me vazhdimin e procedures se prokurimit me fazat e metejshme te saj.

TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

**KRYETAR
Ilir XHAKOLLI**